



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 06

Prishtinë, më 04. 05. 2011, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Në mbledhje morën pjesë: Suzana Novoberdaliu – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj - nënkryetare, Ismet Beqiri, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Duda Balje, Justina Shiroka-Pula dhe Albana Gashi.

Mungoi: Kymete Bajraktari.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi dhe Lejla Selimi – OSBE, Jahir Bejta-Ngritja e Zërit, Nexhat dhe Nafie Kuqi nga Sindikata e Pavarur e Invalidëve dhe Pensionistëve të Kosovës dhe Burim Tahiri, praktikant nga Kuvendi i Kosovës.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi: Suzan Novoberdaliu – kryetare.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 27 prillit 2011,
3. Nxjerrja e konkluzioneve lidhur me peticionin e pensionistëve të SPIPK- së,
4. Caktimi i datës për takimin me zëvendëskryeministren, z. Edita Tahirin, përkitazi me bisedimet me Serbinë lidhur me personat e pagjetur,
5. Shqyrtimi i disa kërkesave,
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës,

Kryetarja propozoi që pikës së katërt të rendit të ditës, caktimi i datës lidhur me takimin me zëvendëskryeministren, z. Edita Tahirin, përkitazi me bisedimet me Serbinë t'i shtohet edhe për fondin e pensionistëve të Kosovës.

Komisioni e miratoi rendin e ditës me plotësimin e pikës së 4- të të propozuar nga kryetarja e Komisionit.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 27.04.2011

Kryetarja konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e datës 27.04.2011 .

2. Nxjerrja e konkluzioneve lidhur me peticionin e pensionerve të SPIPK- së

Kryetarja - Theksoi se Komisioni ka pasur takim me përfaqësuesit e Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Kosovës, të cilët kanë kërkuar zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga Komisioni i legjislaturës së tretë. Ajo lidhur me peticionin tha se kemi autorizuar dy raportues dhe i luti t'i njoftojnë me përmbajtjen e këtyre konkluzioneve.

Rita Hajzeraj- Beqaj- Tha se si grup raportues e kemi shqyrtuar peticionin dhe rekomandojmë Kryesinë e Kuvendit të bëhet debat parlamentar lidhur me gjendjen e pensionistëve dhe invalidëve të punës në Kosovë, ku do të debatohet për shqetësimet e tyre dhe lidhur me këtë pikë hapi debat.

Kryetarja – E falënderoj për punën që e keni bërë. Unë kam një mendim për plotësim dhe ndryshim të pikës së 2-të, të shihet mundësia e ndryshimit dhe reformimit të skemës së pensioneve të menaxhuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe nevoja e veçimit të personave që me vite kanë kontribuar me punë në pensionet e Kosovës. Ne kemi një vërejtje, që e ka dhënë kryetari i Sindikatës së Pensionistëve të Kosovës, ku thotë që të mos jetë, të shihet mundësia e ndryshimit” por „të zgjidhen sa më parë kërkesat e pensionistëve dhe invalidëve në bazë të reformimit të skemës së pensioneve të menaxhuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe nevoja e veçimit të personave që me vite të tëra kanë kontribuar ne fondin pensional të Kosovës.

Ismet Beqiri- Lidhur me rekomandimet theksoi se ka mundësi për disa ndryshime, por edhe në renditje. Ne nuk duhet propozuar, por duhet kërkuar nga Parlamenti që ta radhisë në Seancë Parlamentare për debat, sepse këto, disi e kanë një shkëputje ndërmjet vete, sepse rekomandimet dhe kërkesa për debat parlamentar kanë dallime mes vete, gjithashtu edhe te pika e dytë në fund të asaj që e thatë ju, kryetare, t'i shtohet edhe

kategorizimi i pensioneve. Pastaj në pikën e tretë mendoj se duhet të riformulohet kështu „Kërkohet nga Qeveria e Kosovës të vendos si prioritet zgjedhjen e problemit të fondit të pensionisteve të Kosovës gjatë bisedimeve teknike.

Biserka Kostiq- Pati vërejtje sa i përket materialit të përkthyer, sepse disa herë nuk e ka marrë materialin e përkthyer në gjuhën serbe.

Kryetarja- Lidhur me vërejtjet e dhëna nga parafolësja tha se do të mundohemi që gjithmonë materialet të jenë të përkthyera në gjuhën serbe, por ky material që është vetëm për nevojat e brendshme, dhe pasi ta shqyrtojë Komisioni, do ta finalizojmë dhe do ta kemi në të dy gjuhët.

Albana Gashi- Ceku se sa i përket pikës së dytë dhe të tretë vërejtjet e mija i kam sjellë me shkrim.

Në rekomandimin e pikës 2 thuhet “ Të shihet mundësia e ndryshimit për rritjen e pensioneve”, e nuk tregon mënyrën se si duhet të sigurohen mjetet dhe apriori i iket përgjegjësisë në këtë drejtim.

Arsyetimi nuk është bindës dhe nuk ka argumente kur shprehimisht thuhet se “mungon fondi pensional i Kosovës”, i cili nuk është kthyer nga Serbia, nuk qëndron si arsyetim. Fondi pensional i Kosovës ekziston, por ai është nëpër bankat e huaja dhe organet ose institucionet e Kosovës nuk kanë qasje në të, ose individualisht dikush përfiton nga ky fond, i cili nuk tërhiqet në Kosovë. Ne mendojmë se nuk duhet të vihet në lajthitje pensionisti dhe të thuhet “të shihet mundësia”, por që të veprohet në këtë drejtim dhe të zgjidhet problemi 11 - vjeçar i pensionistëve, të cilët nuk janë duke marrë pensione, por asistencë sociale.

Ne rekomandimin e pikës së 3- të “Kërkohet nga Qeveria që të vendos prioritet lidhur me fondin e pensionistëve të Kosovës gjatë bisedimeve teknike”. Absolutisht jemi për kthimin e fondit pensional të Kosovës, i cili është marrë nga Serbia, ngase ai i takon pensionistëve të Kosovës, por jo të bisedohet gjatë të ashtuquajturave “Biseda teknike”. Kjo është një e drejtë themelore, e cila është e garantuar me të gjitha konventat dhe deklaratat ndërkombëtare, e që është edhe Serbia nënshkruese e tyre.

Kurtan Kajtazi- Duke u ndërlidhur me shqetësimet e pensionistëve kërkoi që t’i propozohet Kuvendit për lejimin e një debati parlamentar.

Ai tha se Komisioni e ka marrë shumë me seriozitet gjendjen e pensionistëve dhe rekomandimet që i kemi dhe në bazë të debatit parlamentar, që ndoshta do të dalë edhe ndonjë rekomandim tjetër.

Sa i përket kategorizimit të pensioneve, kjo gjithsesi duhet të jetë kontribut i dhënësve, a i atyre që marrin pensione në formë të asistencës sociale.

Komisioni, pas një debati konstruktiv dhe gjithëpërfshirës i miratoi në parim rekomandimet e Grupit punues me disa ndryshime si vijon:

1. Kuvendi të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës përgatitjen e projektligjeve lidhur me kategorizimin e pensionistëve dhe invalidëve.
2. Të bëhet ndryshimi dhe reformimi i skemës së pensioneve të menaxhuara nga

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe nevoja e veçimit të pensionistëve që më vite kanë kontribuar në fondin e pensione të Kosovës.

3 .Të kërkohet nga Qeveria që të vendosë në prioritet zgjedhjes së çështjes, lidhur me fondin e pensionistëve të Kosovës gjatë bisedimeve teknike.

Komisioni, pas një debati gjithëpërfshirës, i miratoi rekomandimet e Grupit punues me disa ndryshime dhe lidhur me këtë nxori këtë:

Përfundim

Komisioni i rekomandon Kryesisë së Kuvendit të Kosovës që të radhitë në mbledhje plenare debat parlamentar për gjendjen e pensionistëve në Republikën e Kosovës, duke kërkuar për miratim rekomandimet e theksuara më lart.

4. Caktimi i datës për takimin me zëvendëskryeministren, z. Edita Tahirin, përkitazi me bisedimet me Serbinë, lidhur me personat e pagjetur dhe kthimin e fondit të pensionistëve të Kosovës.

Kryetarja- Lidhur me këtë pikë theksoi se meqë një nga fushat me sensitive është fusha e të pagjeturve të Kosovës, nga kryetari i Komisionit qeveritar për persona të pagjetur thotë se nuk kam dijeni, a do të ketë bisedime me Serbinë për personat e pagjetur dhe ne, si Komision, duhet ta kemi të qartë të dimë, a do të ketë bisedime? Nëse bisedohet, duhet të dimë se çka bisedohet, prandaj e kem parë të arsyeshme ta ftojmë në një takim të radhës të Komisionit dhe t'i bëjmë pyetje rreth kësaj fushe se për çka ne jem të interesuar.

Komisioni, pas një debati konstruktiv dhe gjithëpërfshirës, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nxori këtë

Përfundim

Komisioni vendosi që në mbledhjen e 25 majit të ftojë znj. Edita Tahiri dhe ta informohet lidhur me përmbajtjen e bisedimeve teknike në mes të Kosovës dhe Serbisë për personat e pagjetur, si dhe për fondin pensional.

5. Shqyrtimi i disa kërkesave

Suzan Novoberdalu, kryetare - I njoftoi anëtarët e Komisionit se ka pasur takim me kryetarin e shoqatës „Ngritja e Zërit” nga Skenderaj. Ajo tha se kjo shoqatë po bën një punë të madhe dhe humane lidhur me ngritjen e padive rreth dëmeve rreth kompensimit të dëmeve të luftës, të shkaktuar nga shteti serb. Në vijim tha se kjo shoqatë pa kompensim ngriti paditë dhe nuk ka kurrfarë mbështetje materiale nga institucionet e Kosovës dhe nga Komisioni kërkohet që çështja të ngrihet në institucionet përkatëse. Ajo e ftoi përfaqësuesin e shoqatës që ta marrë fjalën.

Jahir Bejta- I njoftoi anëtarët e Komisionit në pika të shkurtra rreth aktivitetit të kësaj shoqate dhe për kompetencat e saj. Sipas tij, kjo shoqatë ka 800 anëtarë dhe deri më tani ka ngritur më së 300 padi, të cilat iu janë dorëzuar gjykatave kompetente.

Në fund i kërkoi Komisionit brenda fushëveprimtarisë së vet ta sensibilizojë dhe të ndihmohen materialisht në kryerjes e ushtrimit të funksionit të saj.

Ismet Beqiri- Duke u ndërlidhur me veprimtarinë e kësaj shoqate e falënderoi për kontributin human që e jep, por tha se Komisioni nuk ka mundësi t'i ofrojë ndihmë materiale, ngase nuk është kompetent për këtë çështje.

Kurtan Kajtazi- E përgëzoj shoqatën për punën që e bën, por anëtarët i informoi se Qeveria e Kosovës e ka themeluar Institutin për Krimet e Luftës, që do të merret në të ardhmen për demet e shkaktuara nga lufta.

Prandaj, Komisioni nuk ka mundësi që t'i mbështesë financiarisht dhe u sugjeroi që të bashkëpunojnë me institutin e ngritur pranë Qeverisë dhe t'i koordinojnë punët.

Rita Hajzeraj- Beqaj- Duke u ndërlidhur me këtë pikë tha se kjo organizatë me mjete vetanake, falas ka ngritur paditë, prandaj i rekomandon Komisionit, t'i mbështesë te organet kompetente, gjegjësisht te Ministria e Drejtësisë, e cila duhet t'i koordinojë punët edhe me institutin i cili merret me këto çështje.

Në fund ishte vullnet i të gjithë diskutuesve, që të gjendet mënyra se do të ndihmohet materialisht dhe u thanë fjalë miradije për punë e bërë.

6. Te ndryshme

Kryetarja- I informoi anëtarët e Komisionit me takimin e grupit punues dhe për punën që është duke u bërë rreth monitorimit të ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje. Gjithashtu, kërkoi nga Qeveria që t'i procedohet kërkesa për përshpejtimin e Projektligjit për personat e pagjetur.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit
